



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine I Industrije-Ministry of Trade and Industry*

### Raport 100 ditorë

10 Prill 2018

#### **Ngritja e kapaciteteve institucionale në Sektorin e Turizmit**

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në kuadër të MTI-së, është përgatitur draft rregullorja për themelimin e Departamentit të Turizmit. Kjo për shkak se ekziston një divizion për politika turistike (me vetem 3 të punësuar), ndërsa analizat tregojnë se ka nevojë për ngritje të paktën në një Departament në mënyrë që të mundësohet menaxhimi më i mirë i politikave turistike dhe të rriten aktivitetet në zhvillimin e turizmit. Draft rregullorja është dërguar në MAP.

#### **Koncept dokumenti për sektorin e turizmit**

Gjatë kësaj periudhe është finalizuar Koncept Dokumenti për sektorin e turizmit i cili adreson përmirësimin e legjislacionit në fushën e turizmit. Ky aktivitet ka qenë i përkrahur nga TAIEK, përmes një eksperti ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takimet e grupit punues (ku janë të përfshirë të gjithë aktorët relevant), por janë mbajtur edhe takime individuale me palët tjera të interesit tilla si: takime me MF, ATK, MPL dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës të cilat kanë dalë si kërkesë apo si rekomandim nga Konsultimi Publik i këtij dokumenti. Ky dokument parasheh një qasje të re në zhvillimin e turizmit dhe propozohet ligji i ri i turizmit në përputhje me Direktivat Evropiane dhe standardet evropiane turistike. Koncept dokumenti është planifikuar që të aprovohet nga Qeveria deri në muajin Qershor.

## **Ngritja e bashkëpunimit me institucionet relevante me qëllim të nxitjes së bizneseve akomoduese në aplikimin për procesin e kategorizimit të strukturave akomoduese**

Është organizuar dhe mbajtur me datën 14 Mars një tryezë e përbashkët me bartësit e zhvillimit të turizmit nëpër 7 rajonet e Kosovës, duek përfshirë edhe inspektoratet komunale. Nga kjo tryezë ka dal si nevojë dhe janë mbajtur edhe takimet rajonale si në Prizren, Gjilan dhe Ferizaj (pritet të mbahen edhe në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Pejë) me të gjitha komunat tjera që janë pjesë e këtyre rajoneve. Qëllimi i këtij aktiviteti ka nxitjen e bizneseve akomoduese për t'iu nënshtruar procesit të kategorizimit të strukturave akomoduese në MTI, duke bashkëpunuar me Drejtoritë Komunale përgjegjëse për turizëm si dhe me inspektoratin komunal. Kjo ka dal si nevojë pasi që deri tani kërkesa e bizneseve për kategorizim ka qenë shumë e vogël.

### **Bashkëpunimi me vendet e rajonit në fushën e turizmit**

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar iniciativa me qëllim të bashkëpunimit me Shqipërinë në fushën e turizmit. Bashkë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë jemi pajtuar për një konferencë e përbashkët Kosovë-Shqipëri që do të mbahet në Prishtinë gjatë muajit Maj. Përveç MTI, kësaj iniciative i është bashkuar edhe MKRS si dhe MMPH nga ana e Kosovës. Kjo konferencë parasheh edhe takime B2B me sektorin privat dhe shoqatat turistike-hoteliere, kulturore dhe mjedisore nga të dy vendet. Me organizimin e kësaj ngjarje është duke punuar MTI.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur dy takime. Një takim në Prishtinë, mes zv. Ministrit për turizëm në Shqipëri dhe zv. Ministrit në MTI. Ndërsa një takim tjetër është mbajtur në Tiranë ku kanë qenë pjesëmarrës nga ana e Shqipërisë, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit bashkë me zv. Ministri i Turizmit, nga ana e Kosovës zv. Ministri dhe stafi i Divizionit të Turizmit nga MTI si dhe zv. Ministri i Turizmit nga Mali i Zi.

» Është duke u punuar edhe në nxitjen e bashkëpunimit me Malin e Zi, respektivisht inicimin e një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e turizmit.